



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.470/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Ferid Osmani dhe Vllastimir Dimiç, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër komisionares Zahide Raci në qendrën e vendvotimit 1921E për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Fryma e re (FER)

ARSYETIMI

Më datën 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik FER në të cilën theksohet se me datën 12.12.2010 rreth orës 13:00 në qendrën e votimit 1921E në shkollën fillore Asim Vokshi, vëzhguesja Fjolla Gërguri ka raportuar se votuesi Vedat Hajrullahu ka hyrë në kabinë me dy fletëvotime, njëra i është shpallur e pavlefshme kurse kryesuesi i qendrës Shaip Gashi e ka regjistruar incidentin dhe ka pohuar se Vedat Hajrullahu ka pasur dy fletëvotime me vete. Nderkaq z Hajrullahu gjithashtu ka pohuar qe dy fletëvotime i janë dhëne nga Zahide Raci.

Ne mbështetje te pretendimeve parashtresuesi i ankeses nuk ka bashkangjitur asnjë prove materiale, përveç se ka siguruar nje numer telefoni i cili i perket Fjolla Gërgurit vëzhguese dhe dëshmitare ne vendngjarje.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 470/2010 më datën 14.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

